

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përmbushje të parimit të llogaridhënies, transparencës dhe detyrimit ligjor, ju raporton sot zhvillimet kryesore për vitin 2017 dhe me sfidat që po përballlet.

Gjatë vitit 2017 ka patur arritje të rëndësishme të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të tregjeve Financiare, të cilat janë evidentuar edhe nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, si partnerët kryesorë dhe kontribues të vyer në asistencën teknike për AMF.

Së pari, të gjitha tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, vijuan prirjen e tyre me rritje, afërsisht dy herë më të lartë se rritja e ekonomisë në tërësi. Totali i aktiveve në këto tregje rezultoi në rreth 105 miliardë lekë me një rritje mesatare prej 6.5% kundrejt vitit 2016.

Treguesi i totalit të aktiveve ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitin 2017 rezultoi 6.9%. Tregu më i madh për tu mbikëqyrur nga niveli i aktiveve mbetet tregu i fondeve të investimeve. Pesha e këtij tregu për vitin 2017 në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF, ishte 69.2%, pesha e tregut të sigurimeve arriti në 29.1%, ndërsa ajo e tregut të pensioneve private vullnetare në 1.7%.

Së dyti, Autoriteti si një institucion i pavarur, rregullator dhe mbikëqyrës e ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me kuadrin ligjor, si dhe ka qenë në të njëjtin drejtim me rekomandimet e Kuvendit.

Ndryshimet e propozuara në legjislacionin rregullativ dhe rregulloret e miratuara nga Bordi i AMF-së kanë ndikuar pozitivisht në tregjet nën mbikëqyrje, veçanërisht në drejtim të:

- Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Investitorit;
- Forcimit të rolit mbikëqyrës;
- Nxitjes së zhvillimit të tregut të kapitaleve në funksion të rritjes së ekonomisë së vendit;
- Rritjes së edukimit financiar;
- Forcimit të bashkëpunimit me institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit si dhe me partnerët ndërkombëtarë me misione në vendin tonë.

Së treti, megjithë ecurinë pozitive të rritjes së tregjeve nën mbikëqyrje, disa tregje ende kanë problematika të mbartura si dhe potencialet për rritjen e tyre janë shumë më të mëdha sesa ritmi i rritjes së tyre vjetore. Për të kaluar në një stad të ri të zhvillimit të tyre dhe për tu përballur me sfidat që ofron procesi i integritimit në strukturat evropiane për këto tregje, AMF disa muaj më parë miratoi strategjinë pesëvjeçare (2018 – 2022) dhe ka filluar zbatimin me planin e veprimit vjetor.

Objektivi kryesor i strategjisë është shndërrimi deri në fund të vitit 2022 të tregjeve financiare jobankare nga tregjet ***më të brishta në Ballkanin Perëndimor, në tregjet më të konsoliduara në këtë rajon.***

Të nderuar deputetë,

Në mënyrë të detajuar po raportoj në vijim zhvillimet kryesore të Autoritetit dhe tregjeve përgjatë vitit 2017.

I. Forcimi i Rolit Mbikëqyrës të Autoritetit

Ndër prioritetet e institucionit kanë qenë **rekomandimet** e dhëna nga Kuvendi si dhe nga institucionet partnere ndërkombëtare për:

- **rikthimin në normalitet të funksionimit** të institucionit;
- **si dhe forcimin e kapaciteteve** mbikëqyrëse të Autoritetit.

Në funksion të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, si dhe në zbatim të rekomandimeve të konsulentëve të BB, Bordi i Autoritetit miratoi strukturën e re organizative, si një domosdoshmëri për t'iu përgjigjur dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare. Një nga risitë e kësaj strukture ishte krijimi i strukturave të dedikuara sipas tregjeve nën mbikëqyrje. Me strukturën e re, Mbrojtjes Konsumatore i kushtohet një vëmendje e veçantë, nëpërmjet krijimit të një njësie të posaçme e cila përfshin edhe edukimin financiar.

Forcimi i kësaj strukture ishte e domosdoshme, jo vetëm për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve në mënyrë sa më profesionale dhe të shpejtë, por edhe për të rritur besimin e publikut tek Autoriteti dhe tregjet financiare.

Kjo rezultoi pozitive pasi numri i ankesave dhe kërkesave për informacion u rrit disa herë, gjë që tregon edhe rritje të besimit të konsumatorit.

Përveç shqyrtimit të ankesave, gjatë vitit 2017, Bordi i Autoritetit në funksion të mbrojtjes konsumatore ka marrë vendime konkrete që kanë synuar rregullimin dhe disiplinimin e çështjeve të caktuara.

Një prioritet i rëndësishëm për AMF në vitin 2017 ka qenë fuqizimi i rolit informues dhe edukimi i publikut në lidhje me funksionimin e tregjeve financiare jo-bankare. Kështu Bordi i AMF-së miratoi strategjinë tre-vjeçare “*Për rritjen e besimit të konsumatorit / investitorit në tregjet nën mbikëqyrje*”, si dhe planin e veprimit, zbatimin e të cilës ka filluar prej datës 1 Tetor të vitit 2017.

Rritja e besimit të publikut nëpërmjet edukimit financiar është një objektivi i rëndësishëm në kushtet kur tregjet financiare kanë potenciale të pashfrytëzuara të zhvillimit të tyre. Për këtë arsye, strategjia ka parashikuar setin e plotë të programeve dhe projekteve, si dhe instrumentat për zbatimin me efikasitet të tyre.

Gjatë vitit 2017 u bë vlerësimi i infrastrukturës së IT-së dhe u plotësua mungesa e sistemit mbështetës (back up) duke shmangur risqet e humbjes së të dhënave dhe historikun e sigurimeve për çdo qytetar dhe të dhënat financiare të raportuara nga shoqëritë.

Në muajin tetor përfundoi hedhja në sistemin e ri të regjistrimit elektronik të dëmeve e të gjitha dosjeve, duke krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin me sukses të sistemit Bonus – Malus, pas miratimit të ligjit nga parlamenti.

Viti 2017 shënoi gjithashtu edhe vitin e forcimit të marrëdhënieve bashkëpunuese me institucionet homologe të rajonit, partnerët ndërkombëtarë që asistojnë në Shqipëri si dhe organizatat ndërkombëtare ku aderojmë. Një sërë marrëveshesh u riaktivizuan në shërbim të shkëmbimit të informacionit, eksperiencës dhe praktikave më të mira për një mbikëqyrje efektive si dhe u fuqizua bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit e më gjerë.

Në vitin 2017 puna vijoi me *projektet e asistencës teknike* në funksion të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse e rregullatore të AMF-së për tregjet nën mbikëqyrje, ku më kryesori mbetet *Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” të financuar nga SECO*. Gjatë vitit 2017 është kryer një punë intensive në kuadër të zbatimit të tij. Aktualisht po punohet për hartimin e drafteve të dy ligjeve; për fondet e investimeve dhe për tregun e titujve, si dhe ka filluar zbatimi i fazës së tretë të projektit lidhur me zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe trajnimet e stafit.

Në kuadër të aplikimit për projekte të reja, me përfitime për zhvillimin e tregut të sigurimeve, në gjysmën e dytë të vitit 2017 Shqipëria u përzgjodh si një nga 4 vendet fituese në botë për **Projektin e Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii)**. Projekti synon të promovojë dhe të zhvillojë produktet inovative për popullatën me të ardhura të ulëta, veçanërisht në fushën e bujqësisë, te biznesi i vogël me synim rritjen e shkallës së përfshirjes së grupeve vulnerabël në skemat e sigurimit vullnetar me prime të ulëta.

Bashkëpunimi me rregullatorët ekonomikë dhe financiarë në vend është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Në funksion të këtij bashkëpunimi janë fuqizuar marrëdhëniet me

institucionet, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

Veç bashkëpunimit të mirë me BSH, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera në vend, në funksion të detyrave tona mbikëqyrëse dhe edukuese, kemi realizuar **Marrëveshje apo Memorandume** bashkëpunimi të reja me:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Institutin e Statistikave;
- AKSHI-n (Agjensia Kombëtare e Shoqërive të Informacionit);
- Si dhe me disa universitete në vend.

Për të garantuar një mbikëqyrje efektive dhe të kujdesshme, Autoriteti ka qenë i përkushtuar për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe për të punuar në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregut në përgjithësi me një orientim drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku.

Kështu janë ndryshuar një seri rregulloresh dhe janë miratuar rregullore të reja në funksion të mbrojtjes konsumatore dhe për një mbikëqyrje më efektive.

Vlen të theksohet se Autoriteti ka punuar vetë për hartimin e P/ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike. Pas konsultave me grupet e interesit si dhe sugjerimeve të dhëna nga Banka Botërore, tashmë draftligji është dorëzuar pranë Ministrisë së Financave. Do e vlerësonim miratimin sa më shpejt të tij, pasi ne konsiderojmë se ai do të ndryshojë tërësisht funksionimit e tregut të sigurimit në vend, zbatimin e sistemit Bonus-Malus si dhe administrimin e një shoqërie sigurimi. Duhet theksuar se miratimi i tij është dhe një detyrim që lind nga raport-progresi i fundit i BE-së dhe hap i domosdoshëm për vijimin e plotësimit

të kuadrit ligjor dytësor për ta kthyer tregun e sigurimeve motorrike në një treg modern si në të gjitha vendet e BE-së.

II. Zhvillimet e tregjeve në mbikëqyrje

Tregu i sigurimeve

Autoriteti mbikëqyr 3 tregje financiare, ku më i rëndësishmi është tregu i sigurimeve.

Ritmet e zhvillimit ndër vite të tregut të sigurimeve në krahasim me potencialet që ka, janë modeste dhe kryesisht të fokusuara ende tek produktet e detyrueshme që janë 61.5% të totalit të tregut, ndërsa zhvillimi i produkteve vullnetare është në nivele minimale. Aktivët e tregut të sigurimeve të vitit 2017 krahasuar me një vit më parë u rritën me rreth 4% duke arritur në vlerën 30.6 miliardë lekë ose 2% e PBB.

Në këtë treg ushtrojnë veprimtarinë e tyre 11 shoqëri sigurimi, nga të cilat 8 ushtrojnë veprimtarinë në sigurimin e jojetës dhe 3 në atë të jetës. Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve në vitin 2017 rezultuan në vlerën rreth 16,2 miliardë lekë, me një rritje prej 5.4%, kundrejt një vit më parë, ndërsa numri i kontratave të sigurimit u rritën me 9.7%. Edhe primi i shkruar bruto për frymë është më i ulëti në Evropë, pak më shumë se 5 500 lekë ose 42 Euro, ndërsa çmimi mesatar i një police sigurimi TPL u ul me 0.5% krahasuar me një vit më parë.

Tregu i sigurimeve ka ruajtur të njëjtin konfigurim të tregut shqiptar në vite, ku volumi i primeve të sigurimit të jo-jetës përbën 92 % të totalit të

primeve të tregut të sigurimeve, ndërsa volumi i primeve të sigurimit të jetës zë vetëm 7.44 %. Zhvillimi i produkteve të sigurimit të jetës në vendin tonë është shumë modest, dhe primet e arkëtuara në këtë treg vazhdon të jetë i lidhur me kërkesat e detyrueshme nga ana e institucioneve financiare, si bankat, për procesin e kredidhënies.

Dëmet e paguara u rritën me rreth 16% krahasuar me vitin 2016, por raporti dëme-prime është ende në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Treguesit statistikorë të mësipërm japin panoramën se tregu i sigurimeve ka probleme strukturore. Sfidat kryesore në këtë treg është rritja e besimit tek publiku si dhe përmirësimi i cilësisë së qeverisjes kooperative të shoqërive të sigurimit. Për të rritur besimin e publikut, veç të tjerave të përmendura më sipër, Autoriteti ka rritur ndjeshëm masat mbikëqyrëse gjatë vitit 2017 si dhe ka detyruar shoqëritë të rrisin transparencën me publikun. Për herë të parë të gjithë shoqëritë në faqen e tyre zyrtare të internetit kanë pasqyruar të dhënat financiare të detajuara të aktivitetit të tyre.

Problematika më e madhe e këtij tregu është fondi i kompensimit, i trashëguar e shtuar nga viti në vit duke filluar nga viti 2002.

Për të evidentuar problematikat reale në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe në veçanti për Fondin e Kompensimit, Autoriteti realizoi një inspektim pranë BSHS-së, për verifikimin e dosjeve të Fondit të Kompensimit duke filluar nga viti 2002 e në vazhdim. Me përfundimin e këtij procesi, Autoriteti arriti të krijojë një pasqyrë më të qartë të dosjeve të pashlyera dhe atyre në proces. Gjatë periudhës Qershor - Shtator filloi shpërndarja e dosjeve tek shoqëritë e sigurimit të praktikave më ngjarje të hershme duke filluar nga viti 2002 si dhe pas inspektimit Bordi i Autoritetit në muajin Nëntor mori

vendimin për një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017 që do të paguhej nga shoqëritë e sigurimit në vlerën 250 milionë lekë.

Për vitin 2017 janë paguar dhe skeduar për pagesë rreth 680 milion lekë për detyrimet e prapambetura për fondin e kompesimit ose mbi 50% më shumë krahasuar me një vit më parë. Aktualisht nga rreth 700 qytetarë që prisnim për vite me radhë për të marrë atë që i takonte në fillim të vitin 2017, në këto momente numri i qytetarëve është ulur në rreth 250 dhe brenda pak muajve cdo qytetar që ka të drejtën për të përfituar nga pagesat e fondit të kompesimit dhe ka pritur për vite e vite do i jepet zgjidhje përfundimtare.

Vendimi i bordit i dhjetorit të vitit 2017 për fondin e kompesimit jo vetëm zgjidh përfundimisht pagesat e prapambetura por ndalon përsëritjen e fenomenit të akumulimit të tyre si ka ndodhur më parë me detyrime të papaguara si dhe ngjarje siguri të pa provigjionuara.

Po gjatë vitit 2017 janë konstatuar problematika të mbartura lidhur me zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) i lidhur midis Bankës Qëndrore e Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Problematikat e dala gjatë zbatimit të MoU, lidhen me mbulimet e kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat sipas legjislacionit të dy vendeve nuk mbulojnë përgjegjësinë në territoret reciproke. Për këtë kemi zhvilluar disa takime të përbashkëta me homologët e Republikës së Kosovës dhe jemi në rrugën e zgjidhjes të problemeve të mbartura, por është e domosdoshme nevoja për ndryshime ligjore në të dy vendet me qëllim vlefshmërinë territoriale të këtyre kontratave.

Autoriteti, pas marrëveshjes së nënshkruar në dhjetor me INSTAT, për herë të parë ka llogaritur vetë koeficientët e rinj për përlllogaritjen e dëmeve shëndetësore ku të dëmtuarit nga aksidentet duke filluar nga 1 korriku do të përfitojnë mesatarisht mbi 35% më shumë nga dëmet shëndetësore. Vlen të theksohet se koeficienti i përdorur deri tani ishte

mjaft i vjetër në kohë, rreth një shekull më parë, i një vendi tjetër Italisë dhe i pa përditësuar në dhjetëra vite.

Që prej datës 1 nëntor 2017 shitja e Policave të Sigurimit Kufitar bëhet nëpërmjet raportimit të tyre në kohë reale përmes regjistrit elektronik të sigurimit të detyrueshëm motorik. Kjo masë rregullative siguron standardizimin e tregut të sigurimit për shitjen e të gjitha policave të sigurimit të detyrueshëm si dhe eliminon rastet e policave fallco, mosraportimit apo raportimit të pasaktë.

Gjithashtu për të minimizuar informalitetin gjatë vitit 2017 u vendos që cdo policë siguri duke filluar nga viti 2018 do të kenë një **numri serial** unik si dhe u vendos procedura që duhet të ndjekë byroja dhe shoqëritë për mënyrën e inventarizimit dhe asgjësimit të policave të sigurimit të papërdorura.

Autoriteti gjatë vitit 2017 ka vijuar me inspektimin e plotë në vend në tre shoqëri të siguri të Jo-Jetës duke përmbyllur kështu për tregun e jojetës, ciklin e parë të mbikëqjes sipas metodologjisë me fokus rrezikun.

AMF ka kryer inspektime të përbashkëta me institucione të tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë Shqipërisë si me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave apo në inspektimin e përbashkët me BQK-në pranë shoqërive të siguri që veprojnë në Kosovë, pjesë e shoqërive të siguri me qendër në Shqipëri.

Tregu i Kapitaleve dhe Fondeve

Tregje të tjera që mbikëqyr autoriteti janë ato të Kapitaleve dhe Fondeve që për vitin 2017 janë karakterizuar nga dinamika të reja zhvillimi.

Autoriteti është angazhuar plotësisht për t'iu përgjigjur me një mbikëqyrje sa më efektive këtyre zhvillimeve të shpejta dhe të domosdoshme, duke marrë të gjitha masat për forcimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes **në shërbim të funksionimit efektiv të tregut të kapitaleve dhe fondeve si dhe mbrojtjes së investitorëve.**

Për t'ju përcjellë zhvillimet e këtyre tregjeve në vitin 2017 po ndalem shkurtimisht në secilin prej tyre duke filluar me tregun e fondeve të investimeve

Tregu i Fondeve të Investimit

Tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme duke zënë me 4.8% të PBB-së, duke u shndërruar kështu në një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Zhvillimi i këtij tregu reflekton qartë edhe interesin që kanë **investitorët vendas për alternativa të reja investimi, në prani të një mjedisi me norma të ulëta të interesit.**

Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve në vitin 2017 arritën në 72,7 miliardë lekë me një rritje mbi 11% krahasuar me vitin 2016. Numri i investitorëve në fondet e investimeve arriti në 31,320. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë vendit, të cilat përbëjnë 61.3% të aseteve të këtij tregu.

Sfida kryesore në tregun e fondeve të investimit është administrimi i riskut pasi si rezultat i rritjes së konsiderueshme të këtij tregu mbart në vetvete edhe risk sistemik. Për këtë qëllim, Autoriteti së bashku me konsulentët e BB të projektit të financuar nga SECO po shikon me prioritet përmirësimin e bazës ligjore në drejtim të mbrojtjes së

interesave të investitorëve dhe ndërhyrjes efikase dhe të shpejtë në raste kur kërkohet ndërhyrje nga rregullatori.

Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes së investitorëve, Autoriteti miratoi ndryshime në Rregulloren përkatëse për shoqëritë administruese të fondeve të investimeve duke eliminuar komisione apo tarifa që i ngarkoheshin investitorit pa të drejtë dhe që nuk rrjedhin nga marrëdhënia e tij direkte me shoqërinë administruese të fondeve të investimeve.

Një zhvillim tjetër pozitiv përgjatë vitit 2017 ishte licencimi nga Autoriteti i depozitarit të dytë të fondeve të investimit duke zbatuar kështu rekomandimin e dhënë nga FMN-ja, por dhe mundësinë e rritjes së konkurrencës midis depozitarëve.

Kërkesa e investorëve për alternativa të reja investimi po reflektohet edhe në shprehjen e interesit të shoqërive për krijimin e fondeve të reja të investimit duke i dhënë hov më të lartë zhvillimit të këtij sektori. Në janar 2018 Autoriteti licençoi edhe shoqërinë e tretë të menaxhimit të aseteve të fondeve të investimit.

Në aspektin mbikëqyrës, gjatë vitit 2017 janë kryer inspektime për të vlerësuar transparencën me klientët e Fondeve të Investimeve gjatë shitjes së produktit nga ana e shoqërisë administruese.

Tregu i fondeve të pensioneve private

Një treg që mbikëqyr autoriteti është tregu i fondeve të pensioneve private i cili ka shfaqur një tendencë në rritje, përse i përket numrit të kontribuesve si dhe totalit të aseteve neto nën menaxhimin e shoqërive të administrimit të këtyre fondeve. Numri i anëtarëve në këto fonde arriti në 20,947 anëtarë, duke shënuar një rritje prej 21% ndërsa totali i

aseteve neto të këtij tregu ishte 31% kundrejt një viti më parë. Politika e investimeve të tre fondeve të pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë. Investimet e këtyre fondeve konsistojnë kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë, me rreth 95% ndaj totalit të aseteve.

Megjithë zhvillimet pozitive të këtij tregu, zgjerimi i mbulimit nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së kontribuesve në këtë sistem është një nga sfidat e përbashkëta që kemi në të ardhmen. Asetet e fondeve të pensioneve vullnetare private janë vetëm 0.1% të PBB-së, tregu më i vogël në rajon.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit për të përfituar një pension shtesë nëpërmjet pensionit vullnetare privat është një faktor kyç që nxit zhvillimin e këtij tregu dhe është pjesë e strategjisë së AMF-së për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, por dhe që mund të zgjidh problemet sociale për të ardhmen për brezin e tretë.

Tregu i Kapitaleve

Një treg tjetër që do të ketë rol të rëndësishëm në të ardhmen është tregu i kapitaleve.

Deri tani tregu sekondar ka qenë i limituar në tregun me pakicë të letrave me vlerë ku kanë mbizotëruar blerjet në tregun primar dhe shlyerjet e vlerës nominale në maturim.

Mosfunksionimi i tregut sekondar, i cili mundëson likuiditetin dhe vlerësimin e drejtë të portofolit të aseteve ka qenë ndër vite një ndër mungesat më të mëdha në tregun e kapitaleve në Shqipëri, zhvillimi i të cilit vijon të jetë ende modest.

Krahasuar me vite më parë, interesi i kompanive për të emetuar letra me vlerë është rritur, edhe pse deri tani ka patur zhvillime vetëm në drejtim të emetimit të obligacioneve me ofertë private për investitorët. Në vitin 2017 vlera gjithsej e emetimeve të miratuara arriti në 1,525 milion lekë. Ky fakt përbën një sinjal pozitiv për mundësitë e zgjerimit dhe tregëtimit të obligacioneve të shoqërive aksionare edhe në Bursë që do të rrisë edhe transparencën.

Interesi i shoqërive aksionare për të emetuar obligacione u reflektua edhe në licencimin si kujdestar të një bankë tjetër duke e çuar në 3 numrin e kujdestarëve të obligacioneve të shoqërive aksionare.

Bursa

Viti 2017 ka dhe një zhvillim tjetër të ri në tregun e kapitalit në vend, **Licencimi i Bursës Shqiptare të Titujve, “ALSE”, sha.** Funksionimi i bursës që nga 22 shkurti i këtij viti krijon premisat për zhvillim të tregut të kapitalit, në drejtim të rritjes së transparencës, por edhe duke krijuar mjedisin e përshtatshëm që investitorëve tu jepen mundësi të reja investimi duke rritur njëkohësisht edhe aksesin në burime të reja të kapitalit për biznesin shqiptar. Domosdoshmëria e licencimit të Bursës lidhej edhe me funksionin e rëndësishëm të tregut sekondar për të krijuar likuiditet dhe një vlerësim të drejtë të çmimit të titujve.

Autoriteti po tregohet i kujdesshëm për të monitoruar çdo veprim të bursës për të ofruar transparencë maksimale për investitorët dhe po i kushton vemendje edhe bazës rregullatore të vetë Bursës, në mënyrë që të sigurohet dhe të ofrohet një treg që të krijoj besim për të gjithë operatorët, një treg i drejtë dhe transparent.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Viti 2017 ka qenë një vit që ka patur arritje në aktivitetin e Autoritetit që janë shprehur nga partnerët ndërkombëtarë si dhe nga raportet vlerësuese që kanë publikuar për vendin tonë.

Misionet e Bankës Botërore kanë vlerësuar ndryshimet strukturore dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të autoritetit, ecurinë e zbatimit të projekteve si dhe funksionimin e institucionit.

Gjithashtu **progres - raporti i fundit KE** që propozoi hapjen e negociatave ka vlerësuar disa arritje të institucionit dhe ka vendosur si prioritet miratimin e dy ligjeve për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike si dhe për pensionet private vullnetare.

Ndërsa FMN ne raportin e fundit te publikuar ne prill 2018 vlerëson punën e bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare duke u shprehur se Autoriteti ka bërë progres rrënjësor/vital në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të kapitaleve dhe fondeve.

Pavarësisht këtyre vlerësimeve, ne si Autoritet jemi të vetëdijshëm që ka ende mundësi për përmirësime në drejtim të konsolidimit të institucionit, forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse për t'iu përgjigjur më së miri dinamikës së tregjeve dhe sfidave që ofrojnë proceset integruese në BE.

Sikundër e thashë në fillim të fjalës sime, zhvillimet dhe ecuria e tregjeve që AMF mbikëqyr duken pozitive, institucioni ka rritur performancën, por ne përballemi dhe do të vazhdojmë të përballemi me sfida, të cilat duhen t'i zgjidhim me kurajo dhe me vullnet të përbashkët për ti shërbyer e mbrojtur konsumatorit dhe investitorit që operojnë në tregjet financiare.

Sfida jonë kryesore do të jetë transformimi i tregjeve financiare jobankare nga tregjet më të dobëta në rajon në një nga tregjet financiare më të konsoliduara në Ballkanin Perëndimor me fokus mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

Në përfundim të fjalës sime, dua t'ju siguroj se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të punojë me përkushtim të lartë për arritjen e këtij objektivi e shoqëruar me një mbikëqyrje efektive për të fuqizuar tregjet financiare Jobankare, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit dhe te qytetarët.

Ju falenderoj për vëmendjen Tuaj.